



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 353/11 prot.

Gjirokastrë, më 14.04.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 21, datë 30.3.2026, “Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavaneve përgatitore të PBA 2027-2029”, konfirmohet.

2. Vendimi nr. 22, datë 30.3.2026, “Për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Tepelenë në programin për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënkupton çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

3. Vendimi nr. 23, datë 30.3.2026, “Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim në favor të qendrës ‘ACEG’, një pjesë të objektit publik shkolla 9-vjeçare ‘Asim Zeneli’, fshati Progonat, Bashkia Tepelenë dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë

qëllim”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

4. Vendimi nr. 24, datë 30.3.2026, “Për miratim të marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë”, konfirmohet.

5. Vendimi nr. 26, datë 30.3.2026, “Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Tepelenë”, konfirmohet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Albana Hasanaj

